VENDIM
Nr. 30, datë 28.2.2019

MBI PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "A. E. DISTRIBUTION" SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika1, germa "dh", të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, i ndryshuar, nenit 5 germa "dh"; nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 9 të *"Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe nenit 15, të *"Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s"*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë "A. E. DISTRIBUTION" sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 83, datë 9.6.2016, ka licencuar shoqërinë "A. E. DISTRIBUTION" sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria "A. E. DISTRIBUTION" sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE nr. 157 prot, datë 14.2.2019, ka kërkuar me vullnetin e saj të plotë, heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa e shoqërisë "A. E. DISTRIBUTION" sh.p.k. për heqjen e licencës së furnizimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, germa "dh", *"Heqja e një licence",* të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, i ndryshuar, si dhe nenit 5, germa "dh" të *"Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror"*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë "A. E. DISTRIBUTION" sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike me nr. 345, seria F16, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 9.6.2016.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë kërkuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi